

V E N D I M
Nr. 65, datë 30.1.1998

**PËR KONTROLLIN DHE PEZULLIMIN E VEPRIMEVE FINANCIARE NGA LLOGARITË
BANKARE TË PERSONAVE TË LIDHUR ME SUBJEKTET E KONTROLLIT “VEFA
HOLDING” SH.P.K. “SILVA” SHPK, “KAMBERI” SH.P.K. “CENAJ & CO” SH.P.K. DHE
“M.LEKA” SH.P.K.**

Me propozimin Zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Të vihet nën kontroll dhe të pezullohen, deri në përfundim të procesit të transparencës, veprimet financiare nga llogaritë bankare të personave juridikë a fizikë të lidhur me subjektet e kontrollit “Vefa Holding”, “Silva”, “Kamberi”, “Cenaj” dhe “M. Leka”.

2. Konsiderohen persona të lidhur me subjektet e kontrollit të përcaktuara sipas pikës 1 të këtij vendimi Vehbi Alimuçaj, Pëllumb Shehaj, Ferdinand Kamberi, Lefter Cenaj dhe Mustafa Leka, pjesëtarët dhe të afërmit e tjerë të familjeve të lidhur në mënyrë direkte ose indirekte me drejtimin e subjektit të kontrollit, si dhe ata persona të lidhur në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë.”

3. “Deloitte & Touche”, si administratore e subjekteve të kontrollit, verifikon të gjitha llogaritë bankare të personave që rezultojnë të tillë në kuptim të pikës 2 të këtij vendimi dhe pezullon veprimet financiare të tyre. Për kontrollin financiar të llogarive bankare të personave të lidhur me ta vendos Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano